

Behar Isma
Ushtrues detyre si drejtor në departamentin Ligjor
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
Republika e Kosovës
Zejnel Salihu, Prishtinë
10 000

E premte, 24 nëntor 2017

RE: Komentet dhe kritikrat për Projektligjin e Diasporës

I nderuar z.Isma

Organizata jo-qeveritare Germin ka përpiluar këtë dokument me kritikrat dhe komentet për ndryshime në Projektligjin për Diasporën.

Ligji aktual për diasporën, i miratuar në vitin 2012 që ka për qëllim të ruaj dhe të kultivojë identitetin gjuhësor, kulturor dhe arsimor të diasporës, pritet që në përbërjen e saj të ketë ndryshime përmbytësore. Për dallim nga projektligji i kaluar, në këtë projektligj presim nga ana juaj që të punohet më shumë, dhe se për ndryshimet në draftligjin për Diasporën të merren për bazë sugjerimet dhe vërejtjet të cilat vijnë nga mërgata shqiptare në diasporë, si shqetësime të cilat ata preken direkt edhe nga rregullimi ligjor të cilin do ta ofrojë ky projektligji.

Me shpresë që ky projektligj do të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe përmbytësor.

Sinqerisht,


Behar Xharra
Drejtor Ekzekutiv



Liza Gashi
Drejtoreshë e Programeve



Fjolla Vukshinaj
Koordinatorë e programit [DSDD](#)



**PROJEKTLIGJI PËR DIASPORËN
KOMENTET E ARDHURA NË ORGANIZATËN GERMIN**

Emri dhe Mbiemri: Muhamet Idrizi

Lokacioni: Stuttgart, Gjermani

E-mail: muhamet-idrizi@web.de

Profesioni: Arsimitar i gjuhës shqipe dhe shkencës politike në Baden Wutemberg, Gjermani.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky ligj në kuadër të fushëveprimit të tij ka:
 - 1.1.përmirësimin e statusit dhe mbrojtjen e të drejtave sociale dhe politike si dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.2.ruajtjen e identitetit përmes organizimit të mësimin të gjuhës, kulturës, arsimimit, shkencës dhe sportit;
 - 1.3. shkëmbimin e ekspertizës së diasporës në kuadër të politik-bërjes dhe zhvillimit të vendit;
 - 1.4. promovimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe **kuadrave ne fusha te ndryshme por edhe** komunitetit të bizneseve të diasporës, si dhe me vendet ku gjendet diaspora.

KAPITULLI II DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 4 marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës

1. Me qëllim të promovimit dhe fuqizimit të marrëdhënieve me Republikën e Kosovës, dhe në përputhje me detyrimet e marra përsipër në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe objektivave strategjike për Diasporën, Republika e Kosovës bazon marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës në bashkëpunimin e ndërsjellë dhe në dhënien e ndihmës në fuqizimin e tyre.
2. Marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës janë pjesë integrale e politikave të jashtme të Republikës së Kosovës edhe ne te ardhshmen pjese e kushtetutes te saj.
3. Pjesëtarët e diasporës kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e rregulluara me rregullore të veçantë në fushën e shkollimit, arsimit universitar ne form te nje koutes (10%) dhe përmes bursave dhe praktikës.
4. Ministrat kompetentë nxjerrin vendime për arritjen e të drejtave të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 5 Dita e Diasporës

1. Republika e Kosovës, çdo vit kalendarik, me datën 2 gusht shënon manifestimin qendror "Dita e Diasporës".
- 2.Ministria ndanë çmimet vjetore të meritave për personat, shoqatat dhe institucionet për kontribut të shquar në forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës .
- 3.Ministria me akte nënligjorë do të përcaktojë kriteret për dhënien e çmimeve vjetore. (Pyetje: **Pse jepen pra cmimet tani? Ne cfare kriteret behet kjo?**)

Neni 7 Ndërmjetësimi ndërkombëtar

- 1.Republika e Kosovës ndërmjetëson zbatimin e të gjitha marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare që mbrojnë interesat, të drejtat dhe pozitën e pjesëtarëve të diasporës.
- 2.Republika e Kosovës nxit integrimin e pjesëtarëve të diasporës në jetën shoqërore dhe politike të vendeve pritëse. (Ne cillen form konkret behet kjo?)

KAPITULLI III

Autoritetet përgjegjëse për marrëdhënie me diasporën

Neni 8

Institucionet përgjegjëse

1. **Kushtetuta eshe baza kryesor per veprimin ligjor dhe** Ministria është institucioni kryesor përgjegjës për marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me pjesëtarët e diasporës.
2. **MPJ dhe Ambasadat dhe konsullatat ne bashkpunim ne shkallen e dyte me** Qendra Kulturore e Diasporës është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve në diasporë, brenda fushëveprimit të saj.

Neni 9

Ministria e Diasporës

1. Ministria e Diasporës në fushën e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, është përgjegjëse si në vijim:
 - 1.1 Propozon, harton, dhe zbaton politikën për promovimin e vlerave të diasporës, si dhe mbikëqyrë **zbatimin e tyre mbrenda vendit, vecanërisht neper institucione tjera shtetror;**
 - 1.2 **Detyron edhe** Monitoron aktivitetet ndërmjet ministrive dhe institucioneve tjera kompetente, për bashkëpunim në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës,
 - 1.3 Në koordinim me ministrinë përkatëse për punë të jashtme kujdeset për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës **jasht vendit;**
 - 1.4 Kujdeset për ruajtjen dhe konzervimin e identitetit kulturor të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.5 Kujdeset për ruajtjen e gjuhës amtare të pjesëtarëve të diasporës **ne form te mbeshtetjes financiare edhe ligjore;**
 - 1.6 Zbaton plan programin arsimor për pjesëtarët e diasporës, të hartuar nga Ministria përkatëse për arsim;
 - 1.7 zbaton politika në sferën e kulturës për pjesëtarët e diasporës **me mbeshtetjen edhe nevojat te diasporës;**
 - 1.8 Harton, zbaton dhe koordinon studime, hulumtime dhe programe në fushën e migracionit **shqiptar ne form te bursave, praktikave profesionale dhe bashkpunime universitare;**
 - 1.9 **Lufton per kushtet ma te mira ligjore dhe prekrhse dhe** Koordinon, ofron informata dhe përkrah investimet e pjesëtarëve të diasporës në Kosovë;
 - 1.10 Realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre të organizimit;
 - 1.11 **Koordinon ne Bashkpunim me Ambasada dhe Konsullata** QKKD-të;
 - 1.12 Përgatit, koordinon dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë për Diasporën;
 - 1.13 Realizon marrëveshje me shtetet fqinje **dhe shoqata, fondacione apo organizata tjera shqiptare ne diasporë** apo të tjera në funksion të projekteve të përbashkëta arsimore, kulturore, sportive, ekonomike etj. që kanë të bëjnë me diasporën.

Neni 10

Qendra Kulturore e Diasporës

1. Qendra Kulturore e Diasporës (më tutje: QKD) qëllim kryesor ka ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, gjuhësor dhe kulturor të pjesëtarëve të diasporës, si dhe promovimin e kulturës në shtetin pritës.
2. Themelimi, statusi dhe aktivitetet e QKD-së do të rregullohen me ligj **dhe ne konsultim me komunitetin shqiptar ne vende perkatese ku eshte ideja e nje hapjes** për QKD-në.

Neni 11

Institucionet tjera përgjegjëse

1. Institucionet tjera përgjegjëse për marrëdhënie me diasporën janë:
 - 1.1 **Te gjitha organet shtetror konsultojn MeD per qeshtje te Diaspores para propozimit te ligjeve per parlament.** Ne vazhdim jan te cekur ministrijat dhe detyrat e tyre:
 1. **Ministria kompetente për punë të jashtme, si partner kryesor, MASHTi: Per Konsulltim te pranimeve te kualifikimit te Diaspores, per qeshtje te edukimit ne vecaneri te mesimit plotesues shqip,**

Ministria e Kultures: Per qeshtje Kulturore dhe mundesit e perkrahjes ne veprim ne Kosove
zhvillim ekonomik dhe tregti dhe financave: Ne propozime konkrete per investime,
Ministria e drejtesis dhe ministria e brendshme ne vecanteri ne aspektin e shtetesis, e
Ministria e integritimit evropian: Per bashkpunim ne promovimin e vendit
Ministria e Ambientit: Per projekte ambitaliste
Ministria e Administrates Publike: Rreth aktivizimit te shoqeris civile ne forma te regjistrimit
te OJQ've dhe fondacioneve shqiptare ne Kosove per nje bashpunim ma te fort:
Minsitria e Mirqenjes sociale: Per koordinim dhe bashkpunim ne fushen e filantropis shqiptare
jasht Kosovës ne bashkpunim me MAP

1.2 Komunat dhe institucionet tjera që kanë në kuadër të fushëveprimit të tyre aktivitete që lidhen me marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës apo veprimtaria e të cilëve mund të jetë në interes të tyre.

1.3 Institucionet kompetente që kanë brenda qëllimit të veprimtarisë aktivitetet që lidhen me marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës, janë të detyruar për të koordinuar aktivitetet me Ministrinë.

KAPITULLI IV

MBROJTJA E të drejtave dhe interesave të PJESËTARËVE të diasporës dhe Forcimin e komuniteteve TË TYRE

Neni 12

Ruajtja e gjuhës amtare dhe organizimi i mësimit plotësues

1.Ministria, ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës amtare të pjesëtarëve të diasporës **ne form te buxhetit dhe kriterëve.**

2.Ministria organizon dhe ndihmon procesin e zhvillimit të mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare në diasporë, në vendet **(ne gjitha vendet ku behet nje kerkes e till)** me interes për diasporën dhe Republikën e Kosovës.

3.Ministria shpërndan tekstet dhe materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare. **Ministria perkrah projekte shkenctar dhe huluntuese ne kete fush me bursa shtetore, bashkpunime universitar dhe me perkrahje te MASHTIT.**

4.Ministria përkatëse për arsim, në koordinim me Ministrinë, harton plan programin për mësimin plotësues, përcaktimin e standardeve si dhe procesin e ngritjes profesionale **të mësimdhënësve në diasporë ne bashkpunim me mesimdhense dhe ekspert ne kete fush ne diasporë.**

5.Ministria mundëson përdorimin e e-mësimit dhe teksteve shkollore nga Republika e Kosovës për mësimin plotësues të gjuhës amtare e pjesëtarëve të diasporës.

6.Ministria nxitë përgatitjen e instruktorëve të gjuhës dhe letërsisë në **kolegje (Ne kolegje kurse si jo. Nuk pranohen ne Gjermani ni ekspert dhe ne shum vende tjere)** dhe universitete të huaja, si dhe krijimin e katedrave për gjuhën amtare në universitetet e vendeve ku jetojnë pjesëtarët e diasporës. **Kjo behet me nje planprogram ose kurrikul shtetror dhe me pekrahje financiare per ekspertet shkencore.**

7.Ministria, për realizimin e procesit arsimor, sipas paragrafit 2 të këtij neni bashkërendit dhe koordinon **punët me palen tjeter ne diasporë. (me vendet e rajonit me interesa të përbashkëta) à (kjo duhet te heket. Gjithkund ku eshte interesa)**

Neni 13

Inkurajimi i nxënësve dhe studentëve nga diaspora

1.Republika e Kosovës siguron zbatimin e programeve për mësimin e gjuhës amtare përmes ndarjes së bursave për nxënësit dhe studentët pjesëtarë të diasporës, që ndjekin shkollat apo studiojnë në universitetet publike në Republikën e Kosovës. **Kjo dote rregullohet me nje koute se opaku 10% per diasporë. Studimet me korrespondence dote rishikohen per mundesin ma te mire te diasporës te kycen ne UP per studime.**

2.Me qëllim të lehtësimit të procedurës së regjistrimit, universitetet publike në Republikën e Kosovës obligohen për të përcaktuar kuotat **se paku 10%** e regjistrimit për pjesëtarët e diasporës.

3.Të drejtat në lidhje me tarifat e shkollës dhe akomodimin e studentëve pjesëtarë të diasporës do të barazohet me të drejtat e studentëve nga Republika e Kosovës.

4.Republika e Kosovës u mundëson pjesëtarëve të diasporës që të ndjekin semestrin pa pagesë në studimet e gjuhës amtare, në pajtim me vendimin e lëshuar nga ministri përkatës për arsim. **Studimet e Masterit dhe PHD's per studenta a shkenctare ne fusha te interesit te shtetit dote mbulohen nga Bursa shtetror. Fusha te interesit si ma larte te cekur jan fusha e mesimit plotesues, hulumtime rreth migrimit apo gjendjes te diaspores ne vende te ndryshme, hulumtime ne fush te regjistrimit, organizimit dhe kanalizimit te resourcave te diaspores ne Kosove.**

Neni 14

Përfshirja e të rinjve nga diaspora

Me qëllim të njohjes, inkurajohen organizimet e vizitave të nxënësve, studentëve dhe të rinjve në atdhe, organizime të shkollave verore/dimërore, kampeve, programeve të ndryshme kulturore dhe arsimore, si dhe praktikave profesionale.

Neni 15

Informimi për diasporën

1.Ministria siguron shpërndarjen e nevojshme të informatave për pjesëtarët e diasporës përmes faqeve të saj të internetit, publikimeve të çashme, komunikimit të drejtpërdrejtë me **shoqata e rrjete ne diaaspore te njofshem**, mediave të shkruara dhe elektronike në atdhe dhe diasporë.

2.Radiotelevizioni i Kosovës obligohet që të sigurojë **(15%)** deri në **(20%)** përqind të skemës programore mujore për program dedikuar çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën.

3.Radiotelevizioni i Kosovës, në zbatim të detyrimeve ligjore, harton planin dhe programin e operimit për radio dhe televizion, dhe shërbimet publike të transmetimit për pjesëtarët e diasporës, si dhe rregullojnë orarin dhe mënyrën e transmetimit duke e bërë të çashëm për pjesëtarët e diasporës.

Neni 16

Statusi i pjesëtarit të diasporës

Pytja eshte ketu: Cfare benefiti porvec nje mirenjohes ne form te letre ka ky status? Nese i japit nje Gjermanit, anglezit apo dikujt tjetër (Shembull Rober Elsie posthum) shtetsia thot njeri ok. Por sa per nje leter nuk duhet procedur ligjore. Diaspora me shtetsi nuk ka nevoj per nje status te tille sepse une jam qytetar i shtetit i kerkoj drejtat e mija edhe ne form ligjor.

1. Statusi i pjesëtarit të diasporës mund të fitohet nga **qytetarët e Republikës së Kosovës (na kemi statusi te diaspores se kemi shtetsi, nuk eshte e logjikshme)** që jetojnë jashtë vendit, nga ata qytetarë me prejardhje nga Kosova por pa shtetësi, bashkëshortët e tyre pa origjinë nga Kosova, fëmijët e tyre (të lindur dhe adoptuar), e të cilët kanë kontribuar në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe avancimin e unitetit kulturor.

2. Këtë status mund ta marrin edhe miqtë e popullit të Kosovës dhe të Republikës së Kosovës e të cilët kanë kontribuar për diasporën dhe për çështjen e pavarësisë së Kosovës.

3.Njohja e statusit të pjesëtarit të diasporës, pa shtetësi, nuk nënkupton përkatësinë kombëtare dhe nuk paragjykon procedurën për fitim e shtetësisë së Republikës së Kosovës.

KAPITULLI V

Zhvillimi i bashkëpunimit me pjesëtarët e diasporës

Neni 19

Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

1. Ministria, me qëllim të ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të identitetit, gjuhës, kulturës, traditës dhe trashëgimisë kulturore:

1.1. bashkëpunon dhe ofron mbështetje të gjitha formave (cka don kjo me thon konkret?) të organizimit të pjesëtarëve të diasporës si: shoqatat, organizatat, institutet, qendrat kulturore, dhe të tjera.

1.2. Inkurajon bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet shoqatave dhe institucioneve kulturore të Republikës së Kosovës dhe shoqatave, organizatave dhe formave tjera të organizimit kulturor të pjesëtarëve të diasporës;

1.3. Nxit shkëmbimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës.

Thjesht nje deklarate pa buxhet edhe fusha te veprimit konkret. Ketu sende cdo dite behen.

Neni 20

Qarkullimi i trurit

Ministria, merr masa për të inkurajuar "qarkullimin e trurit" të pjesëtarëve të diasporës në Republikën e Kosovës, për angazhimin e tyre me punë të përkohshme në nivel ekspertësh në institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës **me page dhe perkrahje ne form te resourceve te nevojshme. Ministria fillon krijimit e nje platforme ku te gjith kapacitete njerzor jan te kyqur dhe munden te kontaktohen nga ministrit perkatce dhe institucionet tjera shtetror per nevojat e tyre.**

Neni 21

Bashkëpunimi arsimor dhe shkencor

1. Republika e Kosovës krijon lidhje midis institucioneve të saj arsimore dhe shkencore me shoqatat dhe entitetet tjera përkatëse në diasporë, me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkimit të kapitalit njerëzor, profesional dhe shkencor në atdhe dhe jashtë tij.

Koment: Egzistojn te tilla cilla nuk jan funksional. Shembull konkret eshe University of Education Ludwigsburg dhe UP ku nuk eshte interesuar askush per ma shum se 7 vite., Se paku 30 bursa kan shkuar ne vende tjera per arsyje tze mos kontaktit nga UP. Cka dote behet ketu per njerzi mbrenda institucioneve?

2. Qeveria, nëpërmjet organeve të saja kompetente, zhvillon programe për financimin e projekteve shkencore, me qëllim të tërheqjes së shkencëtarëve që janë pjesëtarë të diasporës.

Koment: Shuma, kapaciteti njerzor, fushat te interesit, bashkpunimi konkret?

Neni 23

Bashkëpunimi në fushën e sportit

1. Republika e Kosovës mbështetë sportistët e rinj të talentuar që janë pjesëtar të diasporës, si dhe inkurajon përfshirjen e tyre në ekipet përfaqësuese.

Koment: Si behet selektimi, mundesi e tregimit te kapacitetit ne form te kampeve, vezghues jasht dhe selektimi i tyre?

2. Ministria inkurajon dhe ndihmon organizimin e garave sportive dhe takimet e sportistëve pjesëtarë të diasporës, si dhe promovimin e tyre në media publike.

Koment: Ministria e Diaspores financon nje turnir ne gjermani te futbollit nga Miftar Dragidella cilla ka aps disa skandale, dhe rahje publike ne vitet e funde per cilla eshte e informuar edhe minsitri. Nese jan projekte te tilla pa kyqje te pales gjermane ma mire eshzte mos me bo fare. NE vitin e fundit ne Kornwestheim te Gjermanis kjo ka ndoll. Askush nuk ka jap llogari.

Neni 24

Mbledhja e të dhënave për pjesëtarët e diasporës

1. Me qëllim të evidentimit të potencialit të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit me pjesëtarët e diasporës, Ministria mbledhë në mënyrë të vazhdueshme dhe ruan të dhënat si në vijim:

1.1 Shkollat dhe universitetet në të cilat mësohen gjuha amtare e pjesëtarëve të diasporës,

1.2 shkencëtarët dhe studiuesit,

1.3 ekspertët e fushave përkatëse,

- 1.4 lobistët për interesa të atdheut,
 - 1.5 politikanë dhe përfaqësues parlamentarë,
 - 1.6 artistë, sportistë, dhe formave të ndryshme të organizimit të tyre.
 - 1.7 Rrjetet e të rinjve, profesionistëve dhe formave tjera të organizimit të tyre.
 2. Ministria realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre të orgnizimit.
 3. Ruajtja dhe mbrojtja e këtyre të dhënave bëhet në pajtim me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.
 4. Secilli qytetar i RKS duhet te regjistrohet ne kufi apo ne formen online para hyrjes ne RKS. Nese kjo nuk ndoll Policia shtetror ka te drejt te ndaloj hyrjen ne RKS. (Njehere behet edhe kryhet kjo pune!)
- Koment: Si mundem une ta shikoj at platform? Ndoshta kam interes te bashkpunimit? Ajo duhet te behet ne form publike.

KAPITULLI VI

përfshirja e diasporës në zhvillim ekonomik

Neni 26

Remitencat

1. Ministria harton projekte zhvillimore për shndërrimin e remitencave në investime.
 2. Qeveria, me propozimin e Ministrisë, përcakton buxhetin vjetor për zbatimin e projekteve zhvillimore të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.
- Koment: Luftim i korrupcionit? Pranimi i kualifikimit te diaspores ne form te nostrifikimit te diplomave? Bond shtetror per projekte? Tregu i vogel?

Neni 27

Mbledhja e të dhënave për biznese

- 1.Me qëllim të evidentimit të potencialit ekonomik të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit në këtë fushë, në bashkëpunim me organet kompetente të Republikës së Kosovës, Ministria mbledh dhe përditëson bazën e të dhënave si më poshtë:
 - 1.1 Biznesmenëve pjesëtarë të diasporës;
 - 1.2 Format e organizimit të bizneseve në diasporë dhe anëtarët e tyre
 2. Ministria përkatëse për tregti dhe institucionet e saja vartëse, mbajnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave si më poshtë:
 - 1.1 për investimet e pjesëtarëve të diasporës në Republikën e Kosovës,
 - 1.2 bilancin e tregtisë së jashtme me vendet ku pjesëtarët e diasporës janë rezidentë.
 3. Organet kompetente të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, janë të obliguara të paraqesin të dhënat Ministrisë.
- Koment: Lehtsime ligjor, subvencione, lehtsim te adminstrates, doganat?
-

Emri dhe Mbiemri: Brikena Muharremi

Lokacioni: Londër, Mbretëria e Bashkuar

E-mail: brikenamuharremi@gmail.com

Profesioni: Avokate, drejtoreshë e Shoqatës së Avokatëve Shqiptaro-Britanik

Neni 4 t'i shtohet kjo: 'Ministrat të konsultohen mundësisht paraprakisht me panëtarët e shoqërisë civile rreth çështjeve në paragrafin 3 të këtij neni'.

Neni 7- paragrafi 2 – Të zëvendësohet me 'Republika e Kosovës nxit integrimin e pjesëtarëve të diasporës në vendet ku jetojnë në të gjitha fushat e ligjshme të veprimit në vendet përkatëse duke përfshirë jetën shoqërore dhe politike.

Neni 8 – paragrafi 2 – Flaja 'përgjegjëse' të zëvendësohet me 'përgjegjës'. 'Qendra Kulturore e Diasporës' të zëvendësohet me 'Qendra e Diasporës' meqë fjala 'kulturore' është kufizuese dhe qendra ishte dashur të ishte gjithëpërfshirëse, pra jo vetëm të mirret me çështje të kulturës por edhe me të gjitha çështjet për të cilat Ministria e Diasporës është përgjegjëse. Për shembull, qendra do të duhej të promovonte integrimin e diasporës në shkencë ose drejtësi përveç tjerave.

Neni 9 – paragrafi 1.3 – Para fjalës 'kujdeset' të shtohet 'dhe institucioneve tjera relevante'.

Neni 9 – paragrafi 1.8 – t'i shtohen pas fjalës 'migracionit' fjalët 'drejtësisë, politikës dhe shkencës'.

Neni 9 – Këtij neni t'i shtohet edhe paragrafet si vijojnë:

'Promovon integrimin e diasporës në vendet ku jetojnë në të gjitha fushat e ligjshme duke përfshirë shkencën, drejtësinë, artet dhe politikën.'

'Promovon dhe nxit anëtarët e diasporës që të kenë respekt për sundimin e ligjit dhe që të jenë qytetarë të denjë të vendeve ku jetojnë.'

'Promovon dhe nxit organizimin e diasporës në shoqata bëmirëse në fushat e lartpërmendura'

'Promovon dhe nxit vullnetarizmin tek anëtarët e diasporës në fushat e lartpërmendura'

Neni 10 – 'Qendra Kulturore e Diasporës' të zëvendësohet me 'Qendra e Diasporës' meqë fjala 'kulturore' është kufizuese dhe qendra ishte dashur të ishte gjithëpërfshirëse, pra jo vetëm të mirret me çështje të kulturës, por edhe me të gjitha çështjet për të cilat Ministria e Diasporës është përgjegjëse. Për shembull, qendra do të duhej të promovonte integrimin e diasporës në shkencë ose drejtësi përveç tjerave. I tërë neni duhet të ndryshohet që qëllimi i Qendrës të jetë sa më i kuartë dhe gjithëpërfshirës.

Neni 11 – paragrafit 1.1 t'i shtohet fjala 'drejtësi' pas fjalës 'shkencë'.

Neni 12 t'i shtohet paragrafi: 'Ministria promovon përfshirjen e gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore në planprogramet e shkollave shtetërore fillore dhe të mesme në vendet ku jetojnë pjesëtarët e diasporës.'

Neni 13 – paragrafi 3 – fjala 'barazohet' të zëvendësohet me 'barazohen'.

Neni 14 – të shtohen pas fjalës 'njohjes' fjalët 'së atdheut dhe krijimit të lidhjeve me atdheun'.

Neni 16 – Nuk është e kjo saktësisht se çfarë të drejtash i jap statusi në fjalë personave dhe për çfarë qëllimi jipet. Duhet të shtjellohet më shumë kjo në këtë nen dhe të ceket saktësisht se çka fiton qytetari nga ky status në mënyrë që të mos ketë keqkuptime apo abuzime.

Neni 19 – paragrafi 1.1 – pas fjalës 'dhe' të shtohet 'u'.

Neni 23 – paragrafi 1 – fjala 'rinj' të hiqet meqë mund të jetë edhe diskriminuese por edhe fokusi duhet të jetë në talent dhe aftësi dhe jo në moshë. Në përgjithësi sportistët janë të rinj por fjala 'rinj' në këtë projektligj nuk është e definuar dhe neni nuk e cek për çfarë moshash bëhet fjalë. Pra ose duhet të caktohen moshat për të cilat bëhet fjalë ose të hiqet fjala nga neni. Gjithashtu është mire të shtohen fjalët 'dhe aktiv' pas fjalës 'talentuar'.

Neni 24 – paragrafi 2 – fjala e fundit duhet të jetë 'organizimit' (gabim shtypi).

Neni 25 – t'i shtohet nenit një paragraf për lehtësimin e regjistrimit të bizneseve dhe investimeve nga diaspora në Kosovë dhe tejkalimin e procedurave burokratike. Do të ishte mirë të krijohet një qendër ose departament i veçantë brenda Ministrisë së Diasporës ose ndonjë ministrie tjetër relevante i cili do të mirrej ekskluzivisht me të gjitha çështjet e investimeve potenciale nga jashtë në Kosovë. Për shembull, qendra do të mirrej me të gjitha çështjet e regjistrimit dhe do të shërbente si udhërrëfyes për biznese.

Neni 26 – paragrafit 1 t'i shtohet 'mundësisht pas konsultimeve paraprake me përfaqësues të diasporës dhe të shoqërisë civile'.

Neni 27 – paragrafi 2 – fjala 'përditësojë' duhet të jetë 'përditësojnë' (gabim shtypi).

Neni 27 – paragrafi 3 – 'të paraqesin' duhet të jetë 't'ia paraqesin' (gabim shtypi).

Në mënyrë që të promovohet pjesëmarrja e diasporës në jetën e Kosovës duhet të hiqen barrierat e ndryshme që ekzistojnë sidomos në kyqjen e profesionistëve në fusha të ndryshme. Për shembull, të përcaktohet me ligj që profesionistët me origjinë nga Kosova të cilët punojnë jashtë vendit dhe të cilët janë të pajisur me licenca pune dhe kualifikime jashtë vendit të mund të punojnë në Kosovë në profesionet e tyre pa pasur nevojë të marrin licencë shtesë dhe leje pune të veçantë. Disa shembuj janë: mjekët, avokatët, arkitektët. Pra, është mirë që një nen të shtohet këtu rreth kësaj. Kushti do të ishte që profesionisti t'a flasë gjuhën e cila i nevojitet për të ushtruar në mënyrë adekuate profesionin në Kosovë dhe të njoh rregullat dhe ligjet përkatëse të Kosovës. Nëse është e nevojshme Kosova mund të përcaktoj shtetet nga të cilat pranohen ose nuk pranohen kualifikimet përkatëse.

Propozimi për përmbajtjen e nenit është ky:

1. Profesionistët me origjinë nga Kosova të cilët punojnë jashtë vendit kanë të drejtën të punojnë në Kosovë në profesionet e tyre përkatëse dhe me licencat dhe kualifikimet e tyre përkatëse me të cilat janë pajisur jashtë vendit pa pasur nevojë të marrin licenca apo kualifikime shtesë në Kosovë. Licencat e tyre të punës dhe kualifikimet njihen nga institucionet përkatëse në Kosovë për kohën për të cilën ato janë valide në vendet përkatëse.
2. Veprimtaria që ata janë të lejuar t'a ushtrorjnë në Kosovë është veprimtaria profesionale që u lejohet në vendet ku jetojnë.
3. Kualifikimet dhe licencat e të gjitha shteteve pranohen përveç këtyre shteteve: (të cekun shtetet nëse është kjo e nevojshme)

4. Profesionistët duhet t'iu përmbahen të gjitha obligimeve ligjore të Kosovës nëse ushtrojnë profesionin e tyre në Kosovë gjithashtu pa shkelur obligimet ligjore të shtetit ku jetojnë.

Emri dhe Mbiemri: Hilmi Gashi

Lokacioni: Bernë, Zvicër

E-mail: hgashi@hotmail.com

Profesioni: Ekspert për Migracion në Sindikatën UNIA, anëtar i Bordi Këshillëdhënës të nismën *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës*, në Germin

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e **marrëdhënieve** ndërmjet Republikës së Kosovës dhe **qytetareve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës jashtë vendit**, përcaktimin e statusit të pjesëtarëve të diasporës, mbrojtjen e të drejtave sociale, **ekonomike, kulturore** dhe politike si dhe interesave tjera të diasporës, si dhe përcaktimin e përgjegjësisive që kanë në këtë fushë autoritetet e Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky ligj në kuadër të fushëveprimit të tij ka:

- 1.1. përmirësimin e statusit dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, **ekonomike, kulturore** dhe politike si dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës **në vendet ku jetojnë dhe në Kosovë**;
- 1.2. ruajtjen e identitetit përmes organizimit të mësimin të gjuhës, kulturës, arsimimit, shkencës dhe sportit;
- 1.3 shkëmbimin e ekspertizës së diasporës në kuadër të politik-bërjes dhe zhvillimit të vendit;
- 1.4. promovimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të bizneseve të diasporës, si dhe me vendet ku gjendet diaspora.

Neni 3 Përkufizimet

1. Në kuptim të këtij ligji:

- 1.1. **'Pjesëtarët e Diasporës'** nënkupton, pjesëtarët e komunitetit të njerëzve me prejardhje nga vendi ynë të cilët jetojnë jashtë tij, kanë lidhje aktive fizike apo emocionale me atdheun apo tek të cilët ekziston vetëdija kolektive për identitetin e tyre dhe vendin e origjinës, duke përfshirë emigrantët dhe pasardhësit e tyre si dhe ata që kanë ndihmuar diasporën dhe pavarësinë e Kosovës.
- 1.2. **'Qeveria'** nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës.
- 1.3. **'Ministria'** nënkupton, Ministrinë përkatëse për diasporën .
- 1.4. **'Ministër'** nënkupton, Ministrin e Ministrisë përkatëse për Diasporën.
- 1.5. **'QKD'** nënkupton, Qendra Kulturore e Diasporës.
- 1.6. **'Qarkullimi i trurit'** nënkupton lëvizja rrethore e punës së kualifikuar në mbarë botën.
(**terminologji e pakuptimtë - duhet të zëvendësohet**)

Neni 9 Ministria e Diasporës

TË LARGOHET NENI 9 NGA KY PROJEKTLIGJ

KAPITULLI IV MBROJTJA E të drejtave dhe interesave të PJESËTARËVE të diasporës dhe Forcimin e komuniteteve TË TYRE

Neni 12

Ruajtja e gjuhës amtare dhe organizimi i mësimit plotësues

1. **Republika e Kosovës nëpërmjet institucioneve të saja** ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës amtare të pjesëtarëve të diasporës. **(largohet Ministria).**
2. **Republika e Kosovës** organizon dhe ndihmon procesin e zhvillimit të mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare në diasporë, në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Kosovës.
3. **Republika e Kosovës** shpërndan tekstet dhe materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare.
4. **Republika e Kosovës** harton plan programin për mësimin plotësues, përcaktimin e standardeve si dhe procesin e ngritjes profesionale të mësimdhënësve në diasporë.
5. **Republika e Kosovës** mundëson përdorimin e e-mësimit dhe teksteve shkollore nga Republika e Kosovës për mësimin plotësues të gjuhës amtare e pjesëtarëve të diasporës.
6. **Republika e Kosovës** nxitë përgatitjen e instruktorëve të gjuhës dhe letërsisë në kolegje dhe universitete të huaja, si dhe krijimin e katedrave për gjuhën amtare në universitetet e vendeve ku jetojnë pjesëtarët e diasporës.
7. **Republika e Kosovës** për realizimin e procesit arsimor, sipas paragrafit 2 të këtij neni bashkërendit dhe koordinon punët me vendet e rajonit me interesa të përbashkëta.

Neni 15

Informimi për diasporën

1. **Republika e Kosovës nëpërmjet institucioneve përkatëse** siguron shpërndarjen e nevojshme të informatave për pjesëtarët e diasporës përmes faqeve të saj të internetit, publikimeve të çashtme, komunikimit të drejtpërdrejtë, mediave të shkruara dhe elektronike në atdhe dhe diasporë.
2. Radiotelevizioni i Kosovës, **si Televizion Publik i vendit, obligohet që të sigurojë** gjashtë (6%) deri në nëntë (9%) përqind të skemës programore mujore për program dedikuar çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën.
3. Radiotelevizioni i Kosovës, në zbatim të detyrimeve ligjore, harton planin dhe programin e operimit për radio dhe televizion, dhe shërbimet publike të transmetimit për pjesëtarët e diasporës, si dhe rregullojnë orarin dhe mënyrën e transmetimit duke e bërë të çashtëm për pjesëtarët e diasporës. Shpenzimet e transmetimit barten prej buxhetit të RTK-së. **Nuk lejohet marrja e pagesave shtesë nga Organizatat, shoqatat apo individ nga Diaspora.**

TË LARGOHET NENI 16 & 17

Rekomandim: Kjo mund të thjeshtëzohet lehtë. Për shembull: "Secili qytetarë apo qytetare i/e RKS, anëtarët e tyre të familjes, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës janë pjesëtar të Diasporës.

KAPITULLI V

Zhvillimi i bashkëpunimit me pjesëtarët e diasporës

Neni 19

Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

1. **Republika e Kosovës me institucionet e saja**, me qëllim të ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të identitetit, gjuhës, kulturës, traditës dhe trashëgimisë kulturore:

1.1. bashkëpunon dhe ofron mbështetje të gjitha formave të organizimit të pjesëtarëve të diasporës si: shoqatat, organizatat, institutet, qendrat kulturore, dhe të tjera.

1.2. Inkurajon bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet shoqatave dhe institucioneve kulturore të Republikës së Kosovës dhe shoqatave, organizatave dhe formave tjera të organizimit kulturor të pjesëtarëve të diasporës;

1.3. Nxist shkëmbimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës.

Neni 20

Qarkullimi i trurit - të pëmirësohet gjuha

Republika e Kosovës merr masa për të inkurajuar "qarkullimin e trurit" të pjesëtarëve të diasporës në Republikën e Kosovës, për angazhimin e tyre me punë të përkohshme në nivel ekspertësh në institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Neni 21

Bashkëpunimi arsimor dhe shkencor

1. Republika e Kosovës krijon lidhje midis institucioneve të saj arsimore dhe shkencore me shoqatat dhe entitetet tjera përkatëse në diasporë, me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkimit të kapitalit njerëzor, profesional dhe shkencor në atdhe dhe jashtë tij.

2. Qeveria, nëpërmjet organeve të saja kompetente, zhvillon programe për financimin e projekteve shkencore, me qëllim të tërheqjes së shkencëtarëve që janë pjesëtarë të diasporës.

3. **Qeveria** inkurajon studime dhe hulumtime sistematike për pjesëtarët e diasporës.

Bashkëpunimi në fushën e sportit

1. **Republika e Kosovës me institucionet e saja** mbështetë sportistët e rinj të talentuar që janë pjesëtar të diasporës, si dhe inkurajon përfshirjen e tyre në ekipet përfaqësuese.

2. **Ajo (Republika e Kosovës)** inkurajon dhe ndihmon organizimin e garave sportive dhe takimet e sportistëve pjesëtarë të diasporës, si dhe promovimin e tyre në media publike.

Neni 24

Mbledhja e të dhënave për pjesëtarët e diasporës

1. Me qëllim të evidentimit të potencialit të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit me pjesëtarët e diasporës, **RKS mbledhë** në mënyrë të vazhdueshme dhe ruan të dhënat si në vijim:

1.1 Shkollat dhe universitetet në të cilat mësohen gjuha amtare e pjesëtarëve të diasporës,

1.2 shkencëtarët dhe studiuesit,

1.3 ekspertët e fushave përkatëse,

1.4 lobistët për interesa të atdheut,

1.5 politikanë dhe përfaqësues parlamentarë,

1.6 artistë, sportistë, dhe formave të ndryshme të organizimit të tyre.

1.7 Rrjetet e të rinjve, profesionistëve dhe formave tjera të organizimit të tyre.

2. Ministria realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre **të organizimit**.

3. Ruajtja dhe mbrojtja e këtyre të dhënave bëhet në pajtim me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27

Mbledhja e të dhënave për biznese

1.Me qëllim të evidentimit të potencialit ekonomik të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit në këtë fushë, në bashkëpunim me organet kompetente të Republikës së Kosovës, Ministria mbledh dhe përditëson bazën e të dhënave si më poshtë:

1.1 Biznesmenëve pjesëtarë të diasporës;

1.2 Format e organizimit të bizneseve në diasporë dhe anëtarët e tyre

2. Ministria përkatëse për tregti dhe institucionet e saja vartëse, mbajnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave si më poshtë:

1.1 për investimet e pjesëtarëve të diasporës në Republikën e Kosovës,

1.2 bilancin e tregtisë së jashtme me vendet ku pjesëtarët e diasporës janë rezidentë.

3.Organet kompetente të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, janë të obliguara të paraqesin të dhënat Ministrisë **(cilës Ministri)**.

Mungojnë edhe disa aspekte të tjera si:

Ruajtja e interesave të Mërgatës në rastin e lidhjes së marrëveshjeve bilaterale mes Kosovës dhe shteteve tjera. Këtu sigurisht duhet shtuar edhe një Kapitull, i cili i obligon Ministrinë, që lidhjet e marrëveshjeve bilaterale të hulumtohen edhe në aspektin e pasojave të mundshme ekonomike dhe atij të të drejtave qytetare të shtetasve të RKS në vendin përkatës.

Në rastin Zvicrës mund të them, se të gjitha Marrëveshjet Bilaterale të nënshkruara mes këtyre dy vendeve shkojnë në favor të Zvicrës dhe asnjë në favor të Mërgatës dhe me të edhe të Kosovës.

Shembull konkret:

Marrëveshja Bilaterale për Pensionet priset nga Zvicra (Resor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale). Dëmi ekonomik (personal dhe për ekonominë e vendit) është i madh. Për Zvicrën një fitim i mirë, sepse me këtë heq "qafe" (gets rid of) shumë pensionist të ardhshëm, të cilët jetojnë në Kosovë dhe nuk paguan më shtesa familjare për fëmijët e mërgimtarëve, të cilët jetojnë në Kosovë.

Në të njëjtën kohë Ministri i Punëve të brendshme nënshkruan Marrëveshjen për Riatdhesim të qytetarëve të Kosovës, të cilët dëbohen prej Zvicrës (bile edhe për arsye banale). Me këtë marrëveshje Zvicra ka krijuar parakushtet për kthimin e të dënuarve për vepra të ndryshme (edhe ato kapitale) që të vuajnë dënimin në burgjet e Kosovës. Kështu pranohet një dënim i dyfishtë: Dënimi për veprë penale dhe ai me dëbim nga Zvicra pa masa adekuate të ruajtjes së të drejtave të tyre si të burgosur dhe pa masa përgatitore të socializmit. Këta njerëz pas vuajtjes së dënimit duhet pasur një perspektivë jetësore.

Këtu duhet sigurisht një Koordinim më i mirë mes Ministrive dhe Diasporës.

- Kapitulli për të drejtat Qytetare si votimi jashtë vendit, përfaqësimi në parlament, proceset e përpilimit apo ndryshimit të ligjeve (afatet, mundësia e auditimit dhe dhënies së propozimeve etj. mungon tërësisht.

Drafti nuk është vetëm i ngarkuar me tekst, por edhe nuk më duket i radhitur mirë. Gjithashtu edhe terminologjia nuk më duket e përshtatshme (p.sh. qarkullimi i trurit!)

Emri dhe Mbiemri: Indira Kartallozi

Lokacioni: Antwerp, Belgjikë

E-mail: indirakartallozi@gmail.com

Profesioni: Eksperte në fushën e Migracionit, drejtoreshë në Kaleidoscope Futures dhe pjesë e Bordit Këshilldhënës të nismës Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës, Germin

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky ligj në kuadër të fushëveprimit të tij ka:
 - 1.1. përmirësimin e statusit dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, **ekonomike** dhe politike si dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës.
 - 1.2. ruajtjen e identitetit përmes organizimit të mësimin të gjuhës, kulturës, arsimimit, shkencës dhe sportit;
 - 1.3. shkëmbimin e ekspertizës së diasporës në kuadër të politik-bërjes dhe zhvillimit të vendit;
 - 1.4. promovimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të bizneseve të diasporës, si dhe me vendet ku gjendet diaspora.

Neni 5 Dita e Diasporës

1. Republika e Kosovës, çdo vit kalendarik, me datën 2 gusht shënon manifestimin qendror "Dita e Diasporës".
2. Ministria ndanë çmimet vjetore të meritave për personat, shoqatat dhe institucionet për kontribut të shquar në forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës (**Këtu nuk po shoh ndonjë pikë esenciale apo frymëzuese. Besoj që do të ishte më mirë ta shfrytëzojmë kohën dhe burimet në një punë domethënëse**)
3. Ministria me akte nënligjorë do të përcaktojë kriteret për dhënien e çmimeve vjetore.

Kohezioni kulturor

1. Republika e Kosovës angazhohet që të afrojë qytetarët e Kosovës që janë në Republikën e Kosovës me pjesëtarët e diasporës, për të krijuar dhe ruajtur kohezionin [IK1] kulturor e social përmes aktiviteteve kulturore, arsimore, shkencore, informuese, ekonomike dhe sportive me qëllim që të ndihmojë ruajtjen dhe fuqizimin e identitetit kombëtar të pjesëtarëve të diasporës.

Kohezion? Se nuk egziston fjalë shqipe për këtë!

KAPITULLI IV MBROJTJA E të drejtave dhe interesave të PJESËTARËVE të diasporës dhe Forcimin e komuniteteve TË TYRE

Neni 12

Ruajtja e gjuhës amtare dhe organizimi i mësimin plotësues

1. Ministria, ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës amtare të pjesëtarëve të diasporës.
2. Ministria organizon dhe ndihmon procesin e zhvillimit të mësimin të gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare në diasporë, në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Kosovës.

3.Ministria shpërndan tekstet dhe materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare.

4. Ministria përkatëse për arsim, në koordinim me Ministrinë, harton plan programin për mësimin plotësues, përcaktimin e standardeve si dhe procesin e ngritjes profesionale të mësimdhënësve në diasporë.

5. Ministria mundëson përdorimin e e-mësimit dhe teksteve shkollore nga Republika e Kosovës për mësimin plotësues të gjuhës amtare e pjesëtarëve të diasporës.

6.Ministria nxitë përgatitjen e instruktorëve të gjuhës dhe letërsisë në kolegje dhe universitete të huaja, si dhe krijimin e katedrave për gjuhën amtare në universitetet e vendeve ku jetojnë pjesëtarët e diasporës. Bravo!

Neni 15

Informimi për diasporën

1. Ministria siguron shpërndarjen e nevojshme të informatave për pjesëtarët e diasporës përmes faqeve të saj të internetit, publikimeve të çashtme, komunikimit të drejtpërdrejtë, mediave të shkruara dhe elektronike në atdhe dhe diasporë.

2. Radiotelevizioni i Kosovës obligohet që të sigurojë gjashtë (6%) deri në nëntë (9%) përqind të skemës programore mujore për program dedikuar çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën. **Nuk po e kuptoj qëllimin e kësaj. Besoj që media në Kosovë promovon mjaftueshëm diasporën.**

3. Radiotelevizioni i Kosovës, në zbatim të detyrimeve ligjore, harton planin dhe programin e operimit për radio dhe televizion, dhe shërbimet publike të transmetimit për pjesëtarët e diasporës, si dhe rregullojnë orarin dhe mënyrën e transmetimit duke e bërë të çashtëm për pjesëtarët e diasporës.

KAPITULLI VI

përfshirja e diasporës në zhvillim ekonomik

Kjo është shumë mikpritëse, por e paqartë dhe pse duket se fokusohet vetëm në investimet e diasporës dhe jo ndonjë nxitje që do të mbështesë investimet nga diaspora.

Neni 25

Nxitja e Investimeve dhe promovimi i eksportit

1.Qeveria, me qëllim të nxitjes së investimeve nga diaspora, angazhohet që bizneset e diasporës të jenë sa më afër me institucionet e Kosovës, në mënyrë që të mundësohet përfaqësimi i interesave të tyre në politikat ekonomike shtetërore.

2. Ministria, me qëllim të nxitjes së investimeve nga diaspora në vendin tonë dhe rritjen e eksportit të prodhimeve dhe shërbimeve tona, inkurajon dhe krijon ura bashkëpunimi ndërmjet rrjeteve të bizneseve dhe biznesmenëve **dhe grave sipërmarrëse (duhet të përmirësohet gjuha në baza gjinore edhe në nenet tjera)** pjesëtarë të diasporës me Republikën e Kosovës dhe bizneseve në Kosovë.

3.Ministria, në bashkëpunim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës harton dhe promovon programe të veçanta për biznese të diasporës.

Emri dhe Mbiemri: Ganimet Bajraktari

Lokcioni: St. Polten, Austri

E-mail: ganimetbajraktari@gmail.com

Profesioni: Defektologe

- 1)Definimi i Diasporës(kush konsiderohet Diasporë dhe kush definohet Mërgimtarë)?
- 2)Këtë propozim Ligjhartuesi e konsideron në përputhje më Kushtetutën e Kosovës! Ky ligj po përgatitet për një Komunitet (Diasporën) dhe Diaspora nuk njihet me Kushtetutën e Kosovës.
- 3) Ky propozim Ligj në as një vend nuk përmend, nuk precizon, nuk parasheh mbrojtje ligjore për pronën e Mërgimtarëve, pronë kjo që kalon vlerën e dhjetëra Miliardë Euro! As një fjalë të vetme për sigurimin e kësaj prone(Shtepijave,Banesave,Tokës...)që ju përket Mërgimtarëve !
- 4.)Qendra Kulturore, për çfarë Organizimi e ka fjalën hartuesi i këtij propozim Ligji? Qendra Kulturore duhet të themelohen,regjistrohen,funksionojnë në bazë të ligjeve, ku jetojnë Mërgimtarët. Hartuesi kërkon përzjerje të kompetencave, të cilat(përzjerje)krijojnë telashe në praktikë. Kjo formë e organizimeve është kopje prej Klubeve Jugosllave, të cilët kontrollonin çdo lëvizje të Mërgimtarëve. Harrtuesi,duhët të ndryshojë këtë qasje!
- 5)Marrëveshje Ndërkombëtare dy palëshe dhe shumëpalëshe. Kjo mbetet në kuadër të një kategorie tjetër, të cilët kanë qëndrim të përkohshëm jashtë vendi(punëtorët sezonal, studentët, pacientët që kërkojnë shërim jashtë vendi...),por në asnjë rrethanë për Diasporën, që kanë shtetësi të vendeve ku jetojnë.
- 6)Në projektligjLigj ,as një fjalë për kontributin e Mërgatës gjatë viteve të 90-ta!A duhet të futët si një aset Kombëtarë ky kontributet dhe të gëzojë mbrojtje ligjore(Fondi i 3 përqindëshit dhe Fondi: Vendlindja thërret).A ka mundësi për kërkim përgjegjësie dhe llogaridhënie?!
- 7)Promovon vlera! Kush promovon vlera: Ministria e Diasporës ose Diaspora. Hartuesi duhet të këtë kujdes rreth këtyre vlerave. Më asgjë deri me tani, nuk e ndihmon Diasporën rreth këtyre vlerave!
- 8)Në bazë të kushtetutës së Kosovës, mbrohen të drejtat e Diasporës. Kjo e drejtë ju afrohet vetëm atyre që njihen më Kushtetutë! Diaspora më Kushtetutë përjashtohet, prandaj nuk ka nevojë të mbrohet diçka që në Kushtetutë nuk ekziston! KUJDES!!!!
- 9) Radio Televizioni i Kosovës, si Medium publik i ofron Diasporës 6% hapësirë, kështu e parasheh hartuesi i këtij Ligji! Kjo hapësirë është më e vogël së e Komuniteteve pakicë në Kosovë. Diaspora e financon këtë Medium!!!
- 10) Hartuesi nuk e parasheh fare përfaqësimin e Diasporës në Institucionet e Kosovës. Është propozim i dalur nga që Diaspora të përfaqësohet: Në Presidencën e Kosovës; në trupat Profesionale në Parlament, Qeveri, Odën Ekonomike të Kosovës. Një përfaqësues i Diasporës të përfshihet në Komisionin Qendror zgjedhor së bashku më Stafin Profesional Kosovarë, të propozojnë një draft që do të përfshinte të drejtat dhe detyrimet e Diasporës.

Ky propozim Ligj është larg çdo kërkesë dhe konsiderohet një propozim Ligj i imponuar për Një Milion Kosovarë, që pa dëshirën e tyre jetojnë jashtë Atdheut.
Këta Mërgimtare konsiderojnë vetën të diskriminuar!

Emri dhe Mbiemri: Avni Dervishi

Lokacioni: Stokholm, Suedi

E-mail: avnidervishi@hotmail.com

Profesioni: Politolog

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ky ligj në kuadër të fushëveprimit të tij ka:
 - 1.1.përmirësimin e statusit dhe mbrojtjen e të drejtave sociale dhe demokratike si dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.2. ruajtjen e identitetit përmes organizimit të mësimin të gjuhës, kulturës, arsimimit, shkencës dhe sportit;
 - 1.3. shkëmbimin e ekspertizës së diasporës në kuadër të politik-bërjes dhe zhvillimit të vendit;
 - 1.4.promovimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të bizneseve të diasporës, si dhe me vendet ku gjendet diaspora.

Neni 7

Ndërmjetësimi ndërkombëtar

- 1.Republika e Kosovës ndërmjetëson zbatimin e të gjitha marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare që mbrojnë interesat, të drejtat dhe pozitën e pjesëtarëve të diasporës.
- 2.Republika e Kosovës nxit integrimin e pjesëtarëve të diasporës në jetën shoqërore dhe politike të vendeve pritëse, **por edhe në vendlindje për ata që e kanë edhe shtetësinë e Republikës së Kosovës.**

KAPITULLI III

Autoritetet përgjegjëse për marrëdhënie me diasporën

Neni 8

Institucionet përgjegjëse

1. Ministria është institucioni kryesor përgjegjës për marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me pjesëtarët e diasporës.
2. Qendra Kulturore e Diasporës është institucioni përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve **kulturore** në diasporë, brenda fushëveprimit të saj.

Neni 9

Ministria e Diasporës

1. Ministria e Diasporës në fushën e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, është përgjegjëse si në vijim:
 - 1.1 Propozon, harton, dhe zbaton politikën për promovimin e vlerave të diasporës, si dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
 - 1.2 Monitoron aktivitetet ndërmjet ministrive dhe institucioneve tjera kompetente, për bashkëpunim në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës,
 - 1.3 Në koordinim me ministrinë përkatëse për punë të jashtme kujdeset për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.4 Kujdeset për ruajtjen dhe konzervimin e identitetit kulturor të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.5 Kujdeset për ruajtjen e gjuhës amëtare të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.6 Zbaton plan programin arsimor për pjesëtarët e diasporës, të hartuar nga Ministria përkatëse për arsim **(në ato vende pritëse ku kjo lejohet);**
 - 1.7 **Zbaton dhe përkrah** politika në sferën e kulturës për pjesëtarët e diasporës;
 - 1.8 Harton, zbaton dhe koordinon studime, hulumtime dhe programe në fushën e migracionit;
 - 1.9 Koordinon, ofron informata dhe përkrah investimet e pjesëtarëve të diasporës në Kosovë;

- 1.10 Realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre të organizimit;
- 1.11 Koordinon QKKD-të;
- 1.12 Përgatit, koordinon dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë për Diasporën;
- 1.13 Realizon marrëveshje me shtetet fqinje apo të tjera në funksion të projekteve të përbashkëta arsimore, kulturore, sportive, ekonomike, **demokratike** etj. që kanë të bëjnë me diasporën.

Neni 11

Institucionet tjera përgjegjëse

1. Institucionet tjera përgjegjëse për marrëdhënie me diasporën janë:
 - 1.1 Ministria kompetente për punë të jashtme, arsim, shkencë, kulturë, zhvillim ekonomik dhe tregti, **si dhe KQZ-në që iu ndihmon pjesëtarëve të Diasporës që kanë shtetësinë e Republikës së Kosovës pjesëmarrje në jetën demokratike.**
 - 1.2 Komunitat dhe institucionet tjera, që kanë në kuadër të fushëveprimit të tyre aktivitete që lidhen me marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës apo veprimtaria e të cilëve mund të jetë në interes të tyre. **Me qëllim rritjen e efektshmërisë në plotësimin e kërkesave të pjesëtarëve të Diasporës si psh rregullimin e dokumenteve apo promovimin e investimeve në nivel lokal, komunitat inkurajohen të kenë person përgjegjës për Diasporën.**
 - 1.3 Institucionet kompetente që kanë brenda qëllimit të veprimtarisë aktivitetet që lidhen me marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës, janë të detyruar për të koordinuar aktivitetet me Ministrinë.

Neni 12

Ruajtja e gjuhës amtare dhe organizimi i mësimin plotësues

1. Ministria **në bashkëpunim me vendet pritëse**, ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës amtare të pjesëtarëve të diasporës **(në ato vende ku ka nevojë).**
2. Ministria organizon dhe ndihmon procesin e zhvillimit të mësimin të gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare në diasporë, në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Kosovës.
3. Ministria shpërndan tekstat dhe materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare.
4. Ministria përkatëse për arsim, në koordinim me Ministrinë, harton planin programin për mësimin plotësues, përcaktimin e standardeve si dhe procesin e ngritjes profesionale të mësimdhënësve në diasporë.

Neni 14

Përfshirja e të rinjve nga diaspora

Me qëllim të njohjes, inkurajohen organizimet e vizitave të nxënësve, studentëve dhe të rinjve në atdhe, organizime të shkollave verore/dimërore, kampeve, programeve të ndryshme kulturore dhe arsimore, si dhe praktikave profesionale. **Studentët dhe mësimdhënësit e universiteteve/kolegjeve në Diasporë do të inkurajohen që të inicojnë programe shkëmbimi për studentë dhe mësimdhënës në mes vendeve pritëse dhe Republikës së Kosovës. Kjo me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe iniciimin e programeve bashkëpunuese.**

Neni 17

Procedurat për marrjen e statusit

1. Kërkesa për marrjen e statusit të pjesëtarit të diasporës pa shtetësi të Republikës së Kosovës, duhet të dorëzohet në Ministri, ose përmes misionëve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.
2. Procedurat dhe kriteret për fitimin e statusit, do të rregullohen me akt nënligjor nga Ministria.
3. Ankesa për refuzimin e statusit mund të paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit.
4. Komisioni i përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendosë për ankesat **(dy nga tre anëtarët janë ose kanë qenë pjesë e Diasporës).**

Neni 20

Qarkullimi i trurit

Ministria, merr masa për të inkurajuar "qarkullimin e trurit" të pjesëtarëve të diasporës në Republikën e Kosovës, për angazhimin e tyre me punë të përkohshme në nivel ekspertësh në institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës. **Me theks të veçantë në ekspertë që mund të involvohen në procesin e Integritimeve Euro-Atlantike dhe ndërkombëtarizimit të vendit, pasi këto janë të identifikuar si interes shtetror jetik i Republikës së Kosovës**

Neni 21

Bashkëpunimi arsimor dhe shkencor

1. Republika e Kosovës krijon lidhje midis institucioneve të saj arsimore dhe shkencore me shoqatat dhe entitetet tjera përkatëse në diasporë, me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkimin e kapitalit njerëzor, profesional dhe shkencor në atdhe dhe jashtë tij.
2. Qeveria, nëpërmjet organeve të saja kompetente, zhvillon programe për financimin e projekteve shkencore, me qëllim të tërheqjes së shkencëtarëve që janë pjesëtarë të diasporës, **si dhe shkëmbimit të përvojave në mes mësimdhënësve në vendlindje dhe vendet pritëse.**
3. Ministria inkurajon studime dhe hulumtime sistematike për pjesëtarët e diasporës.
4. **Ministria planifikon ta inicoj krijimin e Institutin Hulumtues për Diasporës (IHD). Dispozitat ligjore për të cilin do të përcaktohen në përputhshmëri me Strategjinë për Diasporën si dhe prepozitat e tjera përkatëse ligjore.**

Neni 24

Mbledhja e të dhënave për pjesëtarët e diasporës

1. Me qëllim të evidentimit të potencialit të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit me pjesëtarët e diasporës **dhe forcimin e institucioneve të Republikës së Kosovës përmes pjesëmarrjes aktive e pasive**, Ministria mbledhë në mënyrë të vazhdueshme dhe ruan të dhënat si në vijim:
 - 1.1 Shkollat dhe universitetet në të cilat mësohen gjuha amtare e pjesëtarëve të diasporës,
 - 1.2 shkencëtarët dhe studiuesit,
 - 1.3 ekspertët e fushave përkatëse,
 - 1.4 lobistët për interesa të atdheut,
 - 1.5 politikanë dhe përfaqësues parlamentarë,
 - 1.6 artistë, sportistë, dhe formave të ndryshme të organizimit të tyre.
 - 1.7 Rrjetet e të rinjve, profesionistëve dhe formave tjera të organizimit të tyre.
2. Ministria realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre të orgnizimit.
3. Ruajtja dhe mbrojtja e këtyre të dhënave bëhet në pajtim me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 26

Remitencat

1. Ministria harton projekte zhvillimore në transparencë të plotë me Diasporën për shndërrimin e remitencave në investime.
2. Qeveria, me propozimin e Ministrisë, përcakton buxhetin vjetor për zbatimin e projekteve zhvillimore të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Emri dhe Mbiemri: Bekim Hashani

Lokacioni: Gjermani?

E-mail: bekimhashani@gmail.com

Profesioni:

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky ligj në kuadër të fushëveprimit të tij ka:
 - 1.1. përmirësimin e statusit dhe mbrojtjen e të drejtave sociale dhe politike si dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.2. ruajtjen e identitetit përmes organizimit të mësimin të gjuhës, kulturës, arsimimit, shkencës dhe sportit;
 - 1.3. shkëmbimin e ekspertizës së diasporës **ne te gjitha fushat si dhe** në kuadër të politik-bërjes e zhvillimit të vendit;
 - 1.4. promovimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të bizneseve të diasporës, si dhe me vendet ku gjendet diaspora.

Neni 3 Përkufizimet

1. Në kuptim të këtij ligji:
 - 1.1. **'Pjesëtarët e Diasporës'** nënkupton, pjesëtarët e komunitetit të njerëzve me prejardhje nga vendi **ynë Kosova**, të cilët jetojnë jashtë tij, kanë lidhje aktive fizike apo emocionale me atdheun apo tek të cilët ekziston vetëdija kolektive për identitetin e tyre dhe vendin e origjinës, **duke përfshirë emigrantët dhe (të largohet kjo pjesë: pse duhet tani te perdeoret termi Emigrant? Nese po perkufizojeni, perndryshe shkakton huti!** pasardhësit e tyre si dhe ata që kanë ndihmuar diasporën dhe pavarësinë e Kosovës.
 - 1.2. **'Qeveria'** nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës.
 - 1.3. **'Ministria'** nënkupton, Ministrinë përkatëse për Diasporën .
 - 1.4. **'Ministër'** nënkupton, Ministrin e Ministrisë përkatëse për **Diasporën**.
 - 1.5. **'QKD'** nënkupton, Qendra Kulturore e Diasporës.
 - 1.6. **'Qarkullimi i trurit'** nënkupton lëvizja rrethore e punës së kualifikuar në mbarë botën.

Neni 4 marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës

1. Me qëllim të promovimit dhe fuqizimit të marrëdhënieve me Republikën e Kosovës, dhe në përputhje me detyrimet e marra përsipër në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe objektivave strategjike për Diasporën, Republika e Kosovës bazon marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës në bashkëpunimin e ndërsjellë dhe në dhënien e ndihmës në fuqizimin e tyre.
2. Marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës janë pjesë integrale e politikave të jashtme të Republikës së Kosovës.
3. Pjesëtarët e diasporës kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e rregulluara me rregullore të veçantë **në të gjitha nivelet në** fushën e shkollimit, arsimit universitar përmes bursave dhe praktikës.
4. Ministrat kompetentë nxjerrin vendime për arritjen e të drejtave të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 5

Dita e Diasporës

1. Republika e Kosovës, çdo vit kalendarik, me datën **2 Gusht** shënon manifestimin qendror "Dita e Diasporës".
2. Ministria ndanë çmimet vjetore të meritave për personat, shoqatat dhe institucionet për kontribut të shquar në forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, **për ata që me punën dhe veprën e tyre të fisme e ngritin lartë dhe bëjnë të njohur emrin e Kosovës në Botë.**
3. Ministria me akte nënligjorë do të përcaktojë kriteret për dhënien e çmimeve vjetore.

Neni 7

Ndërmjetësimi ndërkombëtar

1. Republika e Kosovës ndërmjetëson zbatimin e të gjitha marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat, **interesat** dhe pozitën e pjesëtarëve të diasporës.
2. Republika e Kosovës nxit integrimin **sa më të mirë** të pjesëtarëve të diasporës në jetën shoqërore, **publike** dhe politike të vendeve pritëse.

Neni 8

Institucionet përgjegjëse

1. Ministria **e Diasporës** është institucioni kryesor përgjegjës për marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me pjesëtarët e diasporës.
2. Qendra Kulturore e Diasporës është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve në diasporë, brenda fushëveprimit të saj.

Neni 9

Ministria e Diasporës

1. Ministria e Diasporës në fushën e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, është përgjegjëse si në vijim:
 - 1.1 Propozon, harton, dhe zbaton politikën për promovimin e vlerave të diasporës, si dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
 - 1.2 Monitoron aktivitetet ndërmjet ministrive dhe institucioneve tjera kompetente, për bashkëpunim në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës,
 - 1.3 Në koordinim me ministrinë përkatëse për punë të jashtme kujdeset për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.4 Kujdeset për ruajtjen dhe **kultivimin (të largohet konzervimin)** e identitetit kulturor të pjesëtarëve të diasporës;
 - 1.5 Kujdeset për ruajtjen e gjuhës amëtare të pjesëtarëve të diasporës;

- 1.6 Zbaton plan programin arsimor për pjesëtarët e diasporës, të hartuar nga Ministria përkatëse për arsim;
- 1.7 Zbaton politika në sferën e kulturës për pjesëtarët e diasporës;
- 1.8 Harton, zbaton dhe koordinon studime, hulumtime dhe programe në fushën e migracionit;
- 1.9 Koordinon, ofron informata dhe përkrah investimet e pjesëtarëve të diasporës në Kosovë;
- 1.10 Realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre të organizimit;
- 1.11 Koordinon **Qendrat Kulturore te Diasporës (QKD-të,më tutje: QKD)**
- 1.12 Përgatit, koordinon dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë për Diasporën;
- 1.13 Realizon marrëveshje me shtetet **perkatëse (të largohet fqinje)** në funksion të projekteve të përbashkëta arsimore, kulturore, sportive, ekonomike etj. që kanë të bëjnë me diasporën.

Neni 12

Ruajtja e gjuhës amtare dhe organizimi i mësimin plotësues

1. Ministria, ndihmon në krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhës amtare të pjesëtarëve të diasporës.
2. Ministria organizon dhe ndihmon procesin e zhvillimit të mësimin të gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare në diasporë, **në vendet me interes për diasporën dhe Republikën e Kosovës.** (të largohet pjesa me të kuqe sepse formulimi është përjashtues).
3. Ministria shpërndan tekstet dhe materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare.
4. Ministria përkatëse për arsim, në koordinim me Ministrinë e Diasporës, harton plan programin për mësimin plotësues, përcaktimin e standardeve si dhe procesin e ngritjes profesionale të mësimdhënësve në diasporë.
5. Ministria mundëson përdorimin e **e-mësimin (çka nënkupton e-mësimi?)** dhe teksteve shkollore nga Republika e Kosovës për mësimin plotësues të gjuhës amtare e pjesëtarëve të diasporës.
6. Ministria nxitë përgatitjen e instruktorëve të gjuhës dhe letërsisë në kolegje dhe universitete të huaja, si dhe krijimin e katedrave për gjuhën amtare në universitetet e vendeve ku jetojnë pjesëtarët e diasporës.
7. Ministria, për realizimin e procesit arsimor, sipas paragrafit 2 të këtij neni bashkërendit dhe koordinon punët me vendet e rajonit me interesa të përbashkëta.
8. **Ministria nxitë dhe përkrah themelimin dhe mbarvajtjen e Qendrave Kulturore në vendet përkatëse ku Disapora ndodhet.**

Neni 16

Statusi i pjesëtarit të diasporës

1. Statusi i pjesëtarit të diasporës mund të fitohet nga qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, nga ata qytetarë me prejardhje nga Kosova por pa shtetësi,

bashkëshortët e tyre pa origjinë nga Kosova, fëmijët e tyre (të lindur dhe adoptuar), e të cilët kanë kontribuar në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe avancimin e unitetit kulturor.

2. Këtë status mund ta marrin edhe miqtë e popullit të Kosovës dhe të Republikës së Kosovës e të cilët kanë kontribuar për diasporën dhe për çështjen e pavarësisë së Kosovës, **avancimin e pozitës së saj në Botë.**

3. Njohja e statusit të pjesëtarit të diasporës, pa shtetësi, nuk nënkupton përkatësinë kombëtare dhe nuk paragjykon procedurën për fitim e shtetësisë së Republikës së Kosovës.

4. **Statusi i fitura deshmohete nepermjet ...**

Neni 19

Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

1. **Ministria e Diasporës**, me qëllim të ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të identitetit, gjuhës, kulturës, traditës dhe trashëgimisë kulturore:

1.1. bashkëpunon dhe ofron mbështetje të gjitha formave të organizimit të pjesëtarëve të diasporës si: shoqatat, organizatat, institutet, qendrat kulturore dhe të tjera.

1.2. Inkurajon bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet shoqatave dhe institucioneve kulturore të Republikës së Kosovës dhe shoqatave, organizatave dhe formave tjera të organizimit kulturor të pjesëtarëve të diasporës.

1.3. Nxiti shkëmbimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës.

Neni 20

Qarkullimi i trurit

Ministria e **Diasporës**, merr masa për të inkurajuar "qarkullimin e trurit" të pjesëtarëve të diasporës në Republikën e Kosovës, për angazhimin e tyre me punë të përkohshme në nivel ekspertësh në institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Neni 21

Bashkëpunimi arsimor dhe shkencor

1. Republika e Kosovës krijon lidhje midis institucioneve të saj arsimore dhe shkencore me shoqatat dhe entitetet tjera përkatëse në diasporë, me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe bashkimit të kapitalit njerëzor, profesional dhe shkencor në atdhe dhe jashtë tij.

2. Qeveria, nëpërmjet organeve të saja kompetente, zhvillon programe për financimin e projekteve shkencore, me qëllim të tërheqjes së shkencëtarëve që janë pjesëtarë të diasporës.

3. Ministria e Diasporës, inkurajon studime dhe hulumtime sistematike **në fusha të ndryshme të dijes dhe kulturës** për pjesëtarët e diasporës.

Neni 22

Seksioni muzeor dhe arkivor

Në kuadër të **Muzeut dhe Arkivit** të Kosovës themelohet njësi e veçantë për diasporën.

Neni 23

Bashkëpunimi në fushën e sportit

1. Republika e Kosovës mbështetë sportistët e rinj të talentuar që janë pjesëtar të diasporës, si dhe inkurajon përfshirjen e tyre në ekipet përfaqësuese **të saj.**

2. Ministria inkurajon dhe ndihmon organizimin e garave sportive dhe takimet e sportistëve pjesëtarë të diasporës, si dhe promovimin e tyre në media publike.

Neni 24

Mbledhja e të dhënave për pjesëtarët e diasporës

1. Me qëllim të evidentimit të potencialit të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit me pjesëtarët e diasporës, Ministria mbledhë në mënyrë të vazhdueshme dhe ruan të dhënat si në vijim:

- 1.1 Shkollat dhe universitetet në të cilat mësohen gjuha amtare e pjesëtarëve të diasporës,
- 1.2 shkencëtarët dhe studiuesit,
- 1.3 ekspertët e fushave përkatëse,
- 1.4 lobistët për interesa të atdheut,
- 1.5 politikanë dhe përfaqësues parlamentarë,
- 1.6 artistë, sportistë, dhe formave të ndryshme të organizimit të tyre.
- 1.7 Rrjetet e të rinjve, profesionistëve dhe formave tjera të organizimit të tyre.

2. Ministria realizon dhe përditëson regjistrin e diasporës dhe forma të tyre të orgnizimit.

3. Ruajtja dhe mbrojtja e këtyre të dhënave bëhet në pajtim me ligjin përkatës të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale. (Apo ligjeve të shteteve përkatëse. Duhet të specifikohet për shkatë të ndeshmerise se temes.

Neni 25

Nxitja e Investimeve dhe promovimi i eksportit

1. Qeveria, me qëllim të nxitjes së investimeve nga diaspora, angazhohet që bizneset e diasporës të jenë sa më afër me institucionet e Kosovës, në mënyrë që të mundësohet përfaqësimi i interesave të tyre në politikat ekonomike shtetërore.
2. Ministria, me qëllim të nxitjes së investimeve nga diaspora në vendin tonë dhe rritjen e eksportit të prodhimeve dhe shërbimeve tona, inkurajon dhe krijon ura bashkëpunimi ndërmjet rrjeteve të bizneseve dhe biznesmenëve pjesëtarë të diasporës me Republikën e Kosovës dhe bizneseve në Kosovë.
3. **Ministria e Diaspores**, në bashkëpunim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës harton dhe promovon programe të veçanta për biznese të diasporës.

Neni 26

Remitencat

1. Ministria harton projekte zhvillimore për shndërrimin e remitencave në investime.
2. Qeveria, me propozimin e Ministrisë së Diasporës, përcakton buxhetin vjetor për zbatimin e projekteve zhvillimore të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Mbledhja e të dhënave për biznese

1.Me qëllim të evidentimit të potencialit ekonomik të diasporës, në funksion të rritjes së bashkëpunimit në këtë fushë, në bashkëpunim me organet kompetente të Republikës së Kosovës, Ministria mbledh dhe përditëson bazën e të dhënave si më poshtë:

- 1.1 Biznesmenëve pjesëtarë të diasporës;
- 1.2 **Komunitetit biznesor të diasporës**
- 1.3 Format e organizimit të bizneseve në diasporë dhe anëtarët e tyre

Emri dhe Mbiemri: Atdhe Prevlukaj

Lokacioni: Mbretëria e Bashkuar

E-mail: aprelvukaj1@sheffield.ac.uk

Profesioni:

Neni 4/3 – Qeveria /ministria përkatese e ka obligim që çdo vit t'i ndajë se paku 100 bursa për pjesëtarë të diasporës, për të ardhur, studiuar apo kontribuar në mënyrë përkatese në fushën specifike të specializimit në Kosovë. Këto bursa mund të jenë për studim, hulumtim, apo punim.

Neni 25 –

Të krijohet bazë e të dhënave me mundësi investimi në Kosovë, me interes dhe përparësi të veçantë dedikuar pjesëtarëve të diasporës. Psh.

- a) Zonat ekonomike që hapen, së pari mundësitë investuese iu ndahen pjesëtarëve të diasporës nëpërmjet organeve përkatese informuese.
- b) Diaspora ka të drejtë hapjeje skemave kreditore në Kosovë në bashkëpunim me organizata të akredituara financiare, që ofrojnë rata interesi më të ulëta se sa ato që ofrohen momentalisht në Kosovë.
- c) Diaspora inkurajohet të investojë në bujqësi në toka publike në Kosovë me koncesione të tokës publike për 33 vjet.

Duhet gjithsesi të shtohet edhe një Nen që lehtëson votimin, që është e drejta kryesore munguese.

Emri dhe Mbiemri: Mark Kosmo

Lokacioni: Boston, Shtetet e Bashkuara të Amerikës

E-mail: markkosmo1@gmail.com

Profesioni: Ekonomist, anëtar i Bordi Këshillëdhënës të nismën *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës*, në Germin

Why is there all the stuff about what the Ministry should do in the law?? The law should be as simple as possible -- maybe in a few years there is no Ministry of Diaspora. It seems to me law should say government will do x, y, z via various government institutions with the role of each institution to evolve over time.

2) Not so sure something like Article 5 on Diaspora Day should be in legislation -- its not like its a national holiday -- again that sort of thing should be left up to governments to do as they see fit.

3) I realize this might almost be a final product and not many change will be made -- if that is not the case though then resumably they have looked at legislation from other countries - - there must be tons of examples, but I cannot find any easily online.

4) My general opinion is keep it simple without much language on how to do implementation of various things like citizenship, culture, investment etc... which are in the law now -- the law should just say what should be done -- not so much how it will/should be done -- that is for later laws and regulations and policies -- the simpler this law is the easier it will be to pass it as a start (3-4 page law to start is plenty, i think).